

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NËXTJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDERVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#20

Ministri në aktivitetin e 30 vjetorit të shoqatës "Migjeni" në Slloveni

Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandel Majko mori pjesë dje në aktivitetin e organizuar me rastin e 30 vjetorit të shoqatës kulturore të shqiptarëve "Migjeni" në Lubjanë të Sllovenisë. "Migjeni" është shoqata e parë shqiptare në ish Jugosllavi, e cila ka ngulmuar në kërkimet e saj për njohjen e të drejtave të shqiptarëve. Në këtë përvojë të rëndësishme Ministri i Shtetit për Diasporën i dorëzoi shoqatës titullin "Naim Frashëri", për "Veprimtarinë dhe angazhimin në mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare", titull ky akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu gjatë ceremonisë ju akordua titulli Naim Frashëri (pas vdekjes) edhe ish kryetarit të kësaj shoqate, Gjon Simonit. Ndërsa shoqata "Migjeni" në këtë përvojë të saj, në shenjë falënderimi për punën e bërë për komunitetet shqiptare në botë i akordoi një vlerësim mirënjohjeje. Pjesë e aktiviteteve me rastin e këtij përvojë të shoqatës ishte edhe simpoziumi shkencor, "Si e kapërcyem prapën e shpresës".



Në gjimnazin "Besnik Sykja" në aktivitetin për volejbollisten shqiptare Erblina Bici, kampione epike



Ministri mori pjesë në aktivitetin e organizuar në gjimnazin "Besnik Sykja" me ish nënëen Erblina Bici. Volejbollistja shqiptare luan me ekipin "Igor Volley Novara" në Itali, i cili në muajin maj fitoi finalen e Berlinit në Ligën e Kampioneve (Kampionatin Europian të Volejbollit për Klube) në volejbol për femra. Volejbollistja shqiptare po shikohet si një talent i veçantë në Itali dhe ka marrë vlerësime pozitive edhe nga media sportive. 24 vjeçarja prej vitit 2016 luan në kampionatin italian të volejbollit, ndërkohë që është pjesë e ekipit kombëtar të volejbollit shqiptar. Bici i dhuroi fanellën e ekipit kampion shkolle, e cila këtë vit shënon 25 vjetorin e krijimit.

Vizita në Slloveni, ministri Majko takon homologun Peter Jozef Cesnik



Gjatë vizitës në Slloveni Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandel Majko u takua me homologun e tij z. Peter Jozef Cesnik. Dy ministrat shkëmbuan mendime, vlerësime dhe qasjet e dy vendeve ndaj Diasporave respektive. Gjithashtu u bisedua për vijimin e komunikimit e të shkëmbimit të informacionit në të ardhmenë deri në finalizimin të një dokumenti të bashkëpunimit dyqasht.

Shfaqja e XXVI kulturore folklorike për vlerësimin e pakicave etnike, në Itali

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës morën pjesë në Shfaqjen e XXVI kulturore folklorike për vlerësimin e pakicave etnike, në komunën Santa Caterina Albanese, në Kalabri të Italisë organizuar me 1 qershor. Në rajonin e Kalabrisë ndodhen mjaft komuna arbëreshe, të cilat organizojnë aktivitetet kulturore të vazhdueshme. Organizimi i tyre synon ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave në komunitetin arbëresh, veçanërisht të fëmijet. Konferenca e shqyrtimit u kushtua shkëmbimit të njohur arbëresh Francesco Antonio Santori.

Në Konferencë morën pjesë mjaft personalitete arbëresh, si Prof. Cetina Mazzei, Ambasadore e Kombit dhe organizatore e skitvitetit; kryebashkiakët e komunave Santa Caterina Albanese dhe Cerzeto, z. Lavalle dhe z. Rizzo; albanologët e njohur Altmani dhe Mandalà dhe dhjetra përfaqësues të komunitetit arbëresh. Me nënësit e shkolave arbëreshe të Kalabrisë u zhvillua një konkurs mbi krijimtarinë e Santorit. Në përfundim të konferencës, u ndanë çmime për nënësit dhe interpretuesit më të spikatur.



Sicilia miratoi ligjin rajonal për ruajtjen e identitetit të komuniteteve arbëreshe

Sicilia miratoi ligjin rajonal për të drejtën e arsimit, ku një nen i veçantë parashikon ruajtjen e identitetit gjuhësor dhe kulturor të komuniteteve arbëreshe të Sicilisë. Rajoni i Sicilisë ka përvetësuar legjislativë ndaj ky vendim ka një rëndësi të veçantë pasi është një arritje e rëndësishme për komunitetet historike arbëreshe në Sicili. Lajmin e ka bërë të ditur kryebashkiaku i Piana degli Albanesi, Rosario Petta. Sipas z. Petta, i cili është anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, ky është një ligj i cili pret të rregullojë rrugën formuese të të rinjve arbëreshe në sistemin arsimor italian.



Prezantimi i anëtarit të Këshillit Koordinues të Diasporës, Sokrat Sinaj në televizionin Diaspora, në Zvicër. Diaspora TV është një kanal televiziv i dedikuar për pasqyrimin e lajmeve të komuniteteve të ndryshme në Zvicër i cili transmeton në gjashtë gjuhë të ndryshme